

RAPORT VLERËSIMI

Menaxhimi i mbetjeve në
njësinë administrative
rurale Laknas,
Bashkia Kamëz

MELI

“Metamorfoza e lumit Ishëm-Itinerari i së nesërme”

Tiranë, Prill 2022

Raport Vlerësimi mbi menaxhimin e mbetjeve në njësine administrative rurale Laknas, Bashkia Kamëz



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Leviz Albania si pjesë e projektit të Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Gjetjet, interpretimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet ose pikëpamjet e Leviz Albania, apo partnerëve të tjerë në zbatimin e projektit.

“Metamorfoza e lumit Ishëm-Itinerari i së nesërme”

Tiranë, Mars 2022

Realizuar nga:**RESU**

(në kuadër të projektit “Metamorfoza e lumit Ishëm-Itinerari i së nesërmes”,

Komuniteti lokal për reduktimin e mbetjeve)

Mbështetur nga:**Leviz Albania**

(si pjesë e projektit të zbatuar nga Agjencisë Zviceriane për

Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC)

Punuan me shkrimin e materialit:

Msc. Vjola Bakillari

Msc. Oljam Dervishi

Msc. Ervi Kosta

Kontriboi në shkrimin e materialit:

Flavio Skënderi

Msc. Sonila Sulaj

Punoi në SPSS:

Msc. Ervi Kosta

Realizuan Pyetësoret dhe intervistat

Anxhela Bakiasi, Albina Cela, Arsiel Mardhaja, Donatela Seferaj, Klea Barca, Mariglend Pepmarku,
Xhevahir Docaj

Mars, 2022**Tiranë**

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	4
Parathënie	5
Hyrje.....	6
Konceptet kryesore	8
Institucionet e përfshira në skemën e menaxhimit të mbetjeve	10
Metodat e vlerësimit	13
Kapitulli 1. Situata aktuale e Vend – Depozitimeve ilegale në njësinë administrative rurale Laknas (Bashkia Kamëz).....	14
Situata e Vend-depozitimeve ilegale burim në zonën e Laknasit	16
Kapitulli 2. Komuniteti dhe Bizneset e Zonës – Sjelljet, qëndrimet dhe perceptimet e tyre në lidhje me vend-depozitimet ilegale.	25
Sjelljet, qëndrimet dhe perceptimet e Banorëve në lidhje me vend-depozitimet ilegale.....	26
Të dhënat kryesore demografike	26
Menaxhimi i mbetjeve në komunitet.....	26
Menaxhimi i mbetjeve nga Bashkia Kamëz.....	29
Sjelljet, qëndrimet dhe perceptimet e Bizneseve në lidhje me vend-depozitimet ilegale	33
Kapitulli 3. Pasojat në shëndet dhe mjedis nga bashkëjetesa me vend-depozitimet ilegale.....	34
Sjelljet, qëndrimet dhe perceptimet e Banorëve në lidhje me cilësinë e ujit	35
Cilësia e ujit për konsum nga njerëzit	36
Cilësia e Ujit të puseve në Njësinë Administrative Rurale Laknas	38
8. Përfundime.....	43
9. Rekomandime	44
Aneks	45
Aneks 1.Të dhëna demografike të banorëve të intervistuar	45
Aneks 2. Pyetësori drejtuar banorëve.....	47
Aneks 3. Intervista me përfaqësuesit e bizneseve	56

PARATHËNIE

Duke qënë se qeniet njerëzore kanë një nevojë jetike për të konsumuar ujë çdo ditë në mënyrë që të mbijetojnë, përderisa shumica e aktiviteteve të tyre ekonomike, sociale dhe kulturore e përdorin atë në sasinë dhe cilësinë e nevojshme, popullatat janë vendosur dhe zhvilluar gjithmonë aty ku mund ta kishin të lehtë aksesin në këtë burim të çmuar, pranë një lumi apo liqeni, burimeve apo puseve apo edhe buzë detit¹. Megjithatë, këto burime, të lidhura jashtëzakonisht me territorin që i mbart, nuk janë të pashtershme, madje dhe ai ujë që i rikthehet ciklit, ka një cikli hidrologjik dhe një ritëm stinor. Mbipopullimi po i tkurrë burimet aktuale ujore në kufijtë e tyre. Aktualisht, pak më pak se gjysma e popullsisë globale, 3.6 miliardë njerëz ose 47%, jetojnë në zona që vuajnë mungesën e ujit të paktën 1 muaj çdo vit².

Shqipëria bën pjesë në 53% e popullatës së botës të cilët kanë akses në ujë. Madje, me shifra, 71% e Shqiptarëve kanë akses në ujë të pijshëm, kjo referuar statistikave të UN³. Burimet ujore të Shqipërisë janë të bollshme, me 6 basene kryesore të mëdha, 4 nga të cilët ndodhen vetëm në territorin e Shqipërisë, pra përgjegjësi e jona. Fokusi i këtij raporti do të jetë pellgu ujëmbledhës i Erzen-Ishëm, pasi ka një rëndësi të veçantë për Shqipërinë sepse përfshin qendrën më të madhe urbane: Tiranën, kryeqytetin e Shqipërisë.

Baseni Erzen-Ishëm, njihur ligjërisht si një basen i vetëm, realisht është bashkim i dy baseneve, Baseni i Lumit Erzen, dhe **Baseni i Lumit Ishëm**. Baseni i Lumit Ishëm përfshin gjithë luginën me degët e tij: Lana, Tirana, Tërkuza të cilët në fshatin Larushk formojnë Lumin Gjola. Më tej, Lumi Zeza së bashku me Lumin Gjola në fshatin Bilaj formojnë Lumin Ishëm⁴. Vitet e fundit, për shkak të rritjes së përqendrimit të popullsisë (1/3 e popullsisë jeton përgjatë këtij Baseni), zhvillimit të industrisë dhe zhvillimit të infrastrukturës urbane, uji i lumit në këtë basen rezulton i ndotur.

Le të listojmë disa nga burimet kryesore të ndotjes së lumenjëve:

- 1- Ujërat e Zeza
- 2- Mbetjet e Ngurta Urbane
- 3- Mbetjet Inerte
- 4- Kimikate dhe mbetje të tjera nga industria
- 5- Ndotja nga aktiviteti Bujqësor, etj.

Nga të gjithë burimet e ndotjes të lart përmendura, zgjidhni një prej tyre që baseni i Lumit Ishëm nuk preket? Ndoshta përgjigja e pyetjes së mësipërme është relative, dhe e ndryshme nga personi në person, por grupi RESUs, bazuar në aktivitetet e saj në terren, ka konstatuar që Baseni i Lumit Ishëm, preket nga të gjithë ato burime ndotje, një ndër më alarmantet, për ne, janë vënd-depozitimet ilegale përgjatë lumit.

Lumenjtë janë dhe pjesë e kulturës njerëzore, fakti që për qindra vjet, mbetjet tona i merrte lumi, nuk do të thotë që dhe sot të ekzistojë e njëjta kulturë së jetuari.

Oljam Dervishi

¹ UN Environment. (2017). *A framework for freshwater ecosystem management. Volume 1: Overview and country guide*. New York, NY: United Nations.

² Boretti, A., Rosa, L. Reassessing the projections of the World Water Development Report. npj Clean Water 2, 15 (2019). <https://doi.org/10.1038/s41545-019-0039-9>

³ https://www.sdg6data.org/country-or-area/Albania#anchor_6.1.1

⁴ <https://openprocurement.al/tenders/other/31218b.pdf>

HYRJE

Baseni Ishëm, shtrihet përgjatë rajonit më të populluar dhe të industrializuar të vëndit tonë siç janë: Tirana, Durrësi, Kamza, Vora, Kruja dhe fshatrat përreth tyre. Popullsia e kësaj zone arrin mbi 1 milion banorë. Për shkak të kësaj dendësie, mbetjet plastike që ky basen transporton në detin Adriatik janë plot 503,000 Kg/vit duke na vendosur në krye të listës në Evropë, si kontribuesit kryesorë të sasisë së plastikës që përfundon në Oqean. Depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve përgjatë Lumit janë arsyt kryesorë që na mbajnë në krye të kësaj liste. Studimet tregojnë që ka një lidhje pozitive midis problemeve shëndetësore si astma, turbekulozi apo problemeve të shëndetit mendor me jetesën afër vend-grumbullimeve të mbetjeve.

Njësia administrative rurale Laknas, është pjesë e bashkisë Kamëz. Sipërfaqja e zonës është 4,714,303 metër katrorë (4.7 km² ose 12.6% të sipërfaqjes së Bashkisë Kamëz). Rreth 70% e kësaj sipërfaqe është tokë arë ku mund të zhvillohen aktivitetet bujqësore, ndërsa pjesa tjetër është e zënë nga ndërtimet dhe veprat infrastrukturore. Sipas të dhënave të bëra publike nga bashkia Kamëz deri në 2017 në këtë njësi jetonin 2069 familje ose 10880 banorë. Kjo zonë përshkohet nga lumi i Tiranës dhe Lumi i Lanës, i cili është një rrjedhë mbetjesh urbane me erën e rëndë që e ka pothuajse gjatë gjithë rrjedhës së tij. Lumi i Tiranës dhe përrrenjve Tërkuza dhe Zeza bashkohen duke formuar lumin Ishëm. Prej vitit 2018, shërbimi i menaxhimit të mbeturinave në Bashkinë Kamëz ofrohet nga dy kompani private (95 % Alko Impex dhe 5 % 2T sh.p.k) për gjithë territorin administrativ. Bashkia e Kamzës nuk ka një Plan Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve për territorin gjeografik pas Reformës Territoriale Administrative. Edhe nga informacioni i marrë nga RESU, plani i fundit i Integruar për Menaxhimin e Mbetjeve që Bashkia Kamëz disponon është i vitit 2012. Për këtë arsye, një nga prioritetet kryesore në fushën e menaxhimit të mbetjeve është hartimi i politikës lokale (plani) si një prioritet themelor që do të rregullojë të gjithë kuadrin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në bashki, si dhe rregulloren e shërbimeve, të cilat do ta bëjë planin lokal të zbatueshëm.

Vënd-depozitimet ilegale përgjatë lumit, në zonën e Laknasit kanë qenë dhe janë një problem. Në raportin e studimit të vitit 2020, nga grupi i RESU, në këtë zonë janë identifikuar 5 vendgrumbullime ilegale duke e bërë zonën më të ndotur në bashkinë Kamëz. Nga takimet informale dhe formale të grupit RESU, u konkludua që shkaktari kryesor i situatës në këtë zonë është mungesa e infrastrukturës (konteniereve)⁵. Falë angazhimit të grupit por dhe punës së institucioneve vendore, u bë e mundur vendosja e kontenierëve në disa hapësira ku kontenierët mungonin.

A ndryshoj situata e mbetjeve në zonë? A ekzistojnë më vend-depozitime ilegale përgjatë lumit? Në këtë raport do të gjeni përgjigjen e pyetjeve të mësipërme por edhe më shumë.

Ky studim u realizua në kuadër të projektit **“Metamorfoza e Lumit Ishëm - Itinerari i së nesërme. Komuniteti lokal për reduktimin e mbetjeve”** dhe ka për qëllim:

1. Analizimin e situatës ekzistuese të vend-depozitimeve ilegale nëpërmjet identifikimit në terren dhe hartëzimit të tyre.
2. Njohjen e perceptimeve të grupeve të interesit (Banorë, Biznese, si dhe Institucione vendore) mbi problemin e vend-depozitimeve, shkaktarët si dhe pasojat e këtyre problemeve.
3. Analizimin e pasojave në shëndet dhe mjedis nga vend-depozitimet ilegale.

⁵https://enforcesustainability.org/wp-content/uploads/2020/07/Manual-Praktik_Eleminimi-i-mbetjeve-pergjate-Basenit-te-Ishmit_ENFORCE.zip

Studime të tilla synojnë të forcojnë mbrojtjen e mjedisve lokale dhe të komunitetit duke eliminuar vend-depozitimet e paligjshme dhe reduktuar ndikimet e tyre mjedisore, shëndetësore, financiare dhe sociale. Gjithashtu, në kontekstin strategjik të menaxhimit të mbetjeve, studime të tilla mund të jenë një bazë e rëndësishme në disa aspekte:

- a- Burim të dhënash, për identifikimin e hot-spotëve të mbetjeve përgjatë lumenjëve, në mënyrë që të ndërmerren veprime strategjike për parandalim.
- b- Angazhime me komunitetin – Përfshirja e palëve të interesuara mund të krijojë frymë bashkëpunuese për përfshirjen e komunitetit në projekte që luftojnë vend-depozitimet e paligjshme por dhe probleme të tjera komunitare.
- c- Reduktimin e ndikimeve në mjedis – Targetimi i aksioneve të pastrimit, zbulimi strategjik, hetimi dhe veprimet e zbatimit.
- d- Menaxhimi Financiar Përgjegjës – Duke reduktuar shpenzimet e largimit të vend-depozitimeve të paligjshme, etj.

Natyra dinamike e hedhjes së mbetjeve në mënyrë të paligjshme kërkon që të krijohen plane dhe programe veprimi të cilat duhet të rishikohen herë pas here. Përgjigja efektive ndaj çështjeve të tilla mund të ndryshojë me kalimin e kohës. “Metamorfoza e lumit Ishëm-Itinerari i së nesërme. Komuniteti lokal për reduktimin e mbetjeve” synon të krijojë një praktikë bazë për planet dhe programet e veprimit për të gjithë grupet e interesuara.

KONCEPTET KRYESORE

Në këtë seksion kemi përmbledhur disa përkufizime të termave specifike të përdorur në raport, dhe ekstrakte nga baza ligjore apo shtojcat përkatëse, me qëllim për të ofruar një informacion bazë të përmbledhur në mënyrë që gjetet nga raporti dhe përshkrimet, të jenë sa më të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë të interesuarit.

Cfarë janë vend-depozitimet ilegale?

Vend-depozitimet ilegale, në këtë raport, janë përcaktuar si depozitimet e mbetjeve urbane në zona ku nuk ekziston asnjë leje, licencë apo miratim nga institucionet vendimarrëse për depozitimin e tyre.

Vend-depozitimet ilegale - Burim. I referohet hedhjes së qëllimshme të sasive të mëdha të mbetjeve shtëpiake, materialeve të ndërtimit apo inerte dhe objekteve, të tilla si: gomat, pajisje dhe mobilje, përgjatë lumit. Janë quajtur *burim* pasi janë burim ndotjeje për shkak të afërsisë së tyre me lumenjtë dhe prirjen t'i marre rrjedha gjatë stinës së dimrit.

Vend-depozitimet ilegale - Rastësore. I referohet mbetjeve të cilat janë të grumbulluara në zona të caktuara në mënyrë rastësore të sjella aty për shkak të rrjedhës së ujit të lumit.

Sipas legjislacionit Shqiptar më poshtë janë listuar termat kryesore të përdorura në këtë raport:

"Mbetje urbane" janë mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve, ku përfshihen mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme, të cilat renditen në paragrafin 20 të vendimit nr.99, datë 18.2.2005 të vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve".⁶

"Agjent" është sipërmarrësi që rregullon marrëdhëniet ndërmjet palëve përgjegjëse për rikuperimin ose asgjësimin e mbetjeve, pavarësisht nga fakti nëse i merr mbetjet fizikisht në zotërim apo jo.

"Grumbullim" është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.

"Krijues i mbetjeve" është çdo person, veprimtaritë e të cilit krijojnë mbetje, (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.

"Landfill" është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë: a) një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i landfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit; b) një vend të përhershëm që përdoret për ruajtjen e përkohshme, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të: i) impianteve ku mbetjet shkarkohen për t'u përgatitur për t'u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër; ii) vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se tre vjet përpara

⁶ http://www.akm.gov.al/assets/vendim_i_km_99_18_02_2005-katalogu_shqipetare_i_mbetjeve.pdf

se të rikuperohen ose të trajtohen; iii) vendet ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre.

“Mbetje e ngurtë” është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t’i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.

“Mbetje shtëpiake” janë mbetjet e sektorit familjar nga komunat, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që, për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga komunat, bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.

“Menaxhim i integruar i mbetjeve” është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtijshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agentit.

“Transportim” është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.

“Trajtim” janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.

INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË SKEMËN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Zona e Mbetjeve e përcaktuar nga Studimi i Fizibilitetit miratohet nga këshillat bashkiake të njësive që bëjnë pjesë në të dhe ligjërohen nga autoriteti përgjegjës (potencialisht nga Këshilli i Ministrave pasi janë pranuar nga ministratë përgjegjëse për mjedisin dhe infrastrukturën.

Parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve:

- 1) Parandalimi (i gjenerimit të mbetjeve);
- 2) Ripërdorimi;
- 3) Riciklimi;
- 4) Rikuperimi; dhe
- 5) Asgjësimi i mbetjeve.

Strategjia merr parasysh dhe rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve sipas parimit të ekonomisë qarkulluese për të mundësuar mbrojtjen sa më të plotë të burimeve natyrore dhe rritjen e eficiencës së përdorimit të produkteve.

Ligji i instrukton qeveritë vendore të hartojnë dhe miratojnë kuadrin e nevojshëm rregullator lokal. Kuadri lokal përfshin rregulloret e ndryshme që përcaktojnë proceset e menaxhimit të mbetjeve dhe objektin, përshkruajnë indikatorët, specifikojnë kriteret dhe instruktojnë strukturat lokale në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve si dhe në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin.

Në skemën e mëposhtme jepet në mënyrë skematike hierarkia institucionale e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Kamëz:

Në mënyrë të veçantë funksionet e secilit prej këtyre institucioneve jepen të përmbledhura më poshtë:




Figura 1. Hierarkia institucionale e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Kamëz

Burimi: Ilustrim i autorëve

Ministria e Mjedisit: është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve, rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Mjedisor (IM) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM).

Në varësi të Ministrisë së Mjedisit janë institucionet e mëposhtme:

Inspektorati Mjedisor është përgjegjës për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve, rregulloret teknike dhe teknologjitë.

Agjencitë Rajonale të Mjedisit janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal. Kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhje edhe për landfill-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Inspektorati Sanitar Shtetëror ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai ka për detyrë të vendosë gjoka për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi nuk janë të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë.

Bashkia Kamëz:

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, ligjin 8094/1996, dhe në ligjin nr. 9010/2003 Njësia e Qeverisjes Vendore (NJQV) është përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar.

Bashkia përcakton:

- i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
- ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për menaxhimin e mbetjeve bashkiake në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publik apo privat që t'i grumbullojnë ato;
- iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë menaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret "tip" të miratuara nga ministritë respektive;
- iv. Harton planet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
- v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- vi. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese

Në përputhje me legjislacionin mjedisor për mbetjet, bashkitë kanë detyrime si më poshtë:

- i. Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;

- ii. Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjëndjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen nga mbetjet;
- iii. Të monitorojnë dhe inspektojnë të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualët lokale;
- iv. Të inspektojnë “zotëruesin e mbetjeve” për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
- v. Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e menaxhimit të mbetjeve;
- vi. Të bashkëpunojë me Inspektoratin Mjedisor, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal.
- vii. Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

Brenda bashkisë struktura për menaxhimin e mbetjeve është si më poshtë:

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave bashkiake për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligji 9537).

Policia e bashkiake: ushtron funksionin e saj bazuar në ligjin nr. 8224/1997, është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

METODAT E VLERËSIMIT

Vlerësimi i menaxhimit të mbetjeve në njësinë administrative rurale Laknas u zhvillua duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. GRUMBULLIMI I PËRGJITHSHËM INFORMACIONIT

Metoda: Vëzhgime në terren, hulumtim online, monitorim mediatik, kërkesa zyrtare, takime me banorët

Periudha kohore: Janar – Shkurt 2022

Gjatë kësaj faze grupi i punës ka grumbulluar informacionin e duhur të mundshëm online në lidhje me situatën aktuale të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Kamëz me fokus kryesor njësinë administrative rurale Laknas. Janë monitoruar mediat vizive dhe të shkruara, si dhe është konsultuar dhe njohur kuadri ligjor dhe administrativ lidhur me menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Kamëz.

Informacion më të plotë e kemi marrë nga komunikimet zyrtare me Bashkia Kamëz, një nga institucionet përgjegjëse. Informacionet e marra janë reflektuar në seksionet përkatëse në tekst. Për informacion më specifik në lidhje me temën, janë realizuar takime me banorët dhe bizneset për të kuptuar më mirë nevojat dhe problematikat e tyre në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në zonën e zbatimit të projektit.

2. GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE NË TERREN

Metoda: Plotësim pyetësorësh me banorët, intervista me bizneset lokale

Periudha Kohore: Shkurt 2022

Grumbullimi i të dhënave në terren u realizua kryesisht nëpërmjet takimeve fizike me banorët dhe përfaqësuesit e bizneseve për të plotësuar pyetësorin/intervistën të hartuar specifikisht për vlerësimin. Pyetësi përmbante 36 pyetje me fokus komunitetin (banorët) në zonën e Laknasit. Pyetjet u kategorizuan në disa kategori në lidhje me menaxhimin e mbetjeve. Nëpërmjet tyre ne morëm informacion për menaxhimin e mbetjeve në komunitet nga ana e Bashkisë Kamëz si dhe efektet shëndetësore të shfaqura në banorët e zonës. Material bazë për hartimin e pyetësorit u përdor kuadri ligjor për mbetjet në bashkinë Kamëz si dhe aspektet teorike dhe praktike të menaxhimit të mbetjeve. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për hartimin e intervistave të bizneseve.

Në grumbullimin e të dhënave u angazhuan gjithsej 15 persona duke përfshirë edhe vullnetarët, të cilët u trajnuan paraprakisht nga grupi i punës. Në plotësimin e pyetësorit u ruajt anonimat i të intervistuarit. Në rastin e intervistave u ruajt anonimat i përfaqësuesit të biznesit, por ju mor leje për marrjen e emrit të biznesit për shkak të numrit të vogël të intervistave.

3. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Metoda: EXCEL, SPSS

Periudha Kohore: Shkurt 2022

Fillimisht të dhënat e pyetësorëve u hodhën në një datasheet në programin Microsoft Excel, sipas pyetjeve të listuara. Përpunimi i të dhënave u krye me programin SPSS në të cilin paraprakisht u grupuan alternativat dhe pyetjet që janë trajtuar së bashku; më pas u nxorrën gjetjet kryesore që nevojiteshin për studimin. Ndërsa intervistat u lexuan me kujdes nga grupi i punës duke nxjerrë informacionin më të vlefshëm për vlerësimin dhe më pas interpretimi i tij u vendos në pjesën e përcaktuar në raport.

4. ANALIZAT E UJIT

Metoda: ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016

Periudha Kohore: Shkurt 2022

Për të përcaktuar cilësinë e ujit që konsumohet nga banorët e zonës Laknas, ishte e nevojshme kryerja e analizave baktereologjike për të parë se sa i konsumueshëm është realisht ky ujë.

Prania dhe shtrirja e ndotjes bakterologjike është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e cilësisë së ujit dhe rrezikut për shëndetin e njeriut nga infeksioni. Ekzaminimi i mostrave të ujit për praninë e *Escheria Coli* (*E. coli*), i cili normalisht është prezent në aparatën tretës të njeriut dhe kafshëve të tjera me gjak të ngrohtë, është indikator i një ndotjeje të tillë.

Prezenca e baktereve të tjera Cholimforme mund të jetë më e vështirë për t'u interpretuar, pasi disa nga këto baktere koliforme jetojnë në tokë dhe në ujërat e freskëta sipërfaqësore. Ç'ka do të thotë që nuk janë gjithmonë ato baktere që gjenden në aparatën tretës.

Prandaj, prania e baktereve koliforme, megjithëse nuk është provë e kontaminimit bakterologjik, mund të tregojë keqfunksionim në trajtim, ruajtje ose shpërndarjen e ujit. **[ISO 9308-1:2014]**

KAPITULLI 1.

**SITUATA AKTUALE E VEND – DEPOZITIMEVE ILEGALE
NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RURALE LAKNAS
(BASHKIA KAMËZ)**

HYRJE

Njësia administrative rurale Laknas, është pjesë e bashkisë Kamëz. Sipërfaqja e zonës është 4,714,303 metër katrorë (4.7 km² ose 12.6% të sipërfaqjës së Bashkisë Kamëz). Rreth 70% e kësaj sipërfaqe është tokë arë ku mund të zhvillohen aktivitetet bujqësore, ndërsa pjesa tjetër është e zënë nga ndërtimet dhe veprat infrastrukturore. Sipas të dhënave të bëra publike nga bashkia Kamëz deri në vitin 2017 në këtë njësi jetonin 2069 familje ose 10880 banorë. Kjo zonë përshkohet nga Lumi i Tiranës dhe Lumi i Lanës, i cili është një rrjedhë mbetjesh urbane me erën e rëndë që e ka pothuajse gjatë gjithë rrjedhës së tij. Lumi Tiranës dhe përrenjve Tërkuza dhe Zeza bashkohen duke formuar lumin Ishëm. Vënd-depozitimet ilegale përgjatë lumit, në zonën e Laknasit kanë qenë dhe janë një problem.

SITUATA E VEND-DEPOZITIMEVE ILEGALE BURIM NË ZONËN E LAKNASIT

Fokus i këtij raporti janë vend-depozitimet ilegale burim. Vëzhgimet në terren janë kryer në disa seri vizitash nga anëtarët e grupit RESUs përgjatë njësisë administrative rurale Laknas gjatë periudhës *Shkurt 2022*. **Nisur nga këto vëzhgime, janë identifikuar 11 vetëdëpozitime ilegale burim.** Mbetjet e grumbulluara në vend-depozitimet e ilegale burim kanë një përbërje të larmishme morfologjike, ku dominonjnë mbetjet urbane (plastika, qelqi, mbetje organike, etj.) mbetje inerte, metal si dhe mbetje të tjera të tilla si, gomat, pajisje dhe mobilje.




Figura 2. Vendodhja e vend-depozitimeve të mbetjeve ilegale Burim në zonën e Laknasit. Burimi: RESU

Në tabelën e mëposhtme do të paraqiten në mënyrë më të detajuar vendndodhja e vend-depozitimeve burim dhe vend-depozitimeve rastësore përgjate Lumit të Tiranës në Zonën e Laknasit:

Vendndodhja e Vend-depozitimeve Burim

Përshkrimi


Vend – Depozitimi burim 1:


Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Alba nian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4396329.66

Y: 4581928.06

Ka nje shtrirje gjatësore prej 25m dhe ndodhet vetëm 8m nga shtrati i lumit kur rrjedha është në prurje mesatare të tij. Është shumë pranë vendbanimeve dhe lehtësisht i aksesueshëm. Morfologjia e këtij vend-depozitimi është me përbërje tërësisht urbane. (plastika, karton, qelq, mbetje organike).





**Vend-Depozitimi
Burim 2.**


Vend – Depozitimi burim 2:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4396283.67

Y: 4581912.38

Ka një shtrirje gjatësore prej **30m** ngjitur me shtratin e lumit. Pozicioni i këtij vend-depozitimi e bën burimin kryesor të vend-depozitimeve rastësore. Është lehtësisht i aksesueshëm nga banorët duke u bërë një burim infeksionesh direkte për ta. Morfologjia e këtij vënddepozitimi është me përbërje tërësisht urbane (plastika, karton, qelqi, mbetje organike).



**Vend-Depozitimi
Burim 3.**


Vend – Depozitimi burim 3:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4396330.85

Y: 4582001.95

Ajo që konstatohet në këtë vend-depozitim janë depozitimet inerte të përmasave shumë të mëdha dhe që janë jo më larg se 40m nga shtrati i lumit. Krahës depozitimeve inerte kemi dhe një vend-depozitim mbetjesh urbane pranë tij. Këto mbetje urbane kanë një shtrirje gjatësore prej **3m** dhe janë 10m larg rrjedhës së lumit, në prurje mesatare të tij.



Vend-Depozitimi Burim 4.


Vend – Depozitimi burim 4:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

$X: 4396213.33$

Y: 4582309.31

Ka një shtrirje gjatësore prej **10m** dhe ngjitur me shtratin e lumit. Sasia e mbetjeve të hedhura në këtë vend-depozitim është më e vogël se ato pararendëse por ajo që konstatohet në këtë vend-depozitim janë gjurmët e lëna nga djegia e tyre. Është po ashtu lehtësisht i aksesueshëm nga banorët duke u bërë një burim infeksionesh direkte për ta. Morfologjia e këtij vënddepozitimi është me përbërje urbane (plastika, karton, qelqi, mbetje organike) por dhe mbetje inerte përgjatë zonës.



Vend-Depozitimi Burim 5.


Vend – Depozitimi burim 5:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4396315.27

Y: 4582309.26

Ka një shtrirje gjatësore prej **20m** dhe nuk janë të përqëndruara vetëm në një pikë të caktuar. Ndodhen ngjitur me shtratin e lumit. Sasia e mbetjeve të hedhura në këtë vend-depozitim është e konisderueshme. Gjithashtu konstatohen gjurmë të zjarrvënieve. Morfologjia e këtij vend-depozitimi është me përbërje urbane (plastika, karton, qelqi, mbetje organike).



**Vend-Depozitimi
Burim 6.**


Vend – Depozitimi burim 6:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4396299.61

Y: 4582408.58

Ka një shtrirje gjatësore prej **10m** dhe ngjitur me shtratin e lumit. Pozicioni i këtij vend-depozitimi e bën burimin kryesor të vend-depozitimeve rastësore. Është lehtësisht i aksesueshëm nga banorët duke u bërë një burim infeksionesh direkte për ta. Morfologjia e këtij vend-depozitimi është me përbërje tërësisht urbane (plastika, karton, qelqi, mbetje organike).



**Vend-Depozitimi
Burim 7.**

Vend – Depozitimi burim 7:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4394656.62

Y: 4583464.13

Është vend-depozitimi më i madh i konstatuar përgjatë Lumit të Tiranës. Ka një shtrirje gjatësore mbi 70 m dhe një lartësi mbi 4m. Nga intervistat informale me banorët e zonës, ky vend-depozitim ka qënë një pikë shkarkimi e mbetjeve ndër vite dhe tani nuk është më aktiv si më parë. Por mbetjet e hedhura nuk janë larguar nga aty dhe banorët deklarojnë që shërben si një mburojë për të prandaluar erozionin për shkak të gërryerjes nga lumi.



**Vend-Depozitimi
Burim 8.**

Vend – Depozitimi burim 8:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4394643.53

Y: 4583563.94

Është shumë pranë vend-depozitimit 7, ka një shtrirje gjatësore rreth 5m dhe është në një largësi prej 10m nga rrjedha e Lumit. Morfologjia e këtij vend-depozitimi është me përbërje tërësisht urbane (plastika, karton, qelqi, mbetje organike).



**Vend-Depozitimi
Burim 9.**

Vend – Depozitimi burim 9:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4394522.04

Y: 4583708.25

Për shkak të afërsisë me rrugën dhe Lumin, ky vend-depozitim është një ndër më aktivët në kuptimin e hedhjeve të vazhdueshme të mbetjeve. Nga intervistat jo formale me banorët, në këtë vend-depozitim hidhen mbetje nga biznese të ndryshme. Ashtu siç tregohet edhe në foto, morfologjia e këtij vend-depozitimi është e përbërë nga mbetje gomash jashtë përdorimit, mbetje pjesësh makinash si dhe mbetje urbane (plastika, karton, qelqi, mbetje organike).


Vend - Depozitimi burim 9:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4394494.72

Y: 4584141.93

Ka nje shtrirje gjatësore prej **10m** dhe ndodhet ngjitur me shtratin e lumit. Pozicioni i këtij vend-depozitimi e bën burim kryesor të vend-depozitimeve rastësore. Është lehtësisht i aksesueshëm nga banorët duke u bërë një burim infeksionesh direkte për ta. Morfologjia e këtij vend-depozitimi është me përbërje tërësisht urbane (plastika, karton, qelqi, mbetje organike).



**Vend-Depozitimi
Burim 10.**


Vend - Depozitimi burim 9:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4394262.65

Y: 4584149.26


Ka nje shtrirje gjatësore prej afërsisht **10m** dhe është po ashtu ngjitur me shtratin e lumit. Pozicioni i këtij vend-depozitimi e bën burim kryesor të sasisë së mbetjeve që i merr rrjedha. Morfologjia e këtij vend-depozitimi është me përbërje tërësisht urbane (plastika, karton, qelqi, mbetje organike).



**Vend-Depozitimi
Burim 11.**

Vendndodhja e Venddepozitimeve Rastësore

Përshkrimi



**Vend-Depozitimi
Rastesore 1.**


Vend – Depozitimi Rastësor 1:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4394644.29

Y: 4583662.24

Zë një sipërfaqe rreth 200m² dhe ndodhet brenda hapsirës së një pylli. Mbetjtet janë të sjella nga rrjedha e ujit, kur lumi është në prurjet maksimale të tij. Morfologjia e këtij vend-depozitimi është me përbërje urbane, kryesisht mbetje plastike.



**Vend-Depozitimi
Rastesore 2.**


Vend – Depozitimi Rastësor 2:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4394493.22

Y: 4584092.25

Ka një shtrirje mbi 100m . Mbetjtet janë të sjella nga rrjedha e ujit, kur lumi është në prurjet maksimale të tij. Morfologjia e këtij vend-depozitimi është me përbërje urbane, kryesisht mbetje plastike.



Vend – Depozitimi Rastësor 2:

Koordinatat e sistemit të pozicionit gjeografik (GPS) Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zona 4 janë:

X: 4394465.98

Y: 4583833.83

Ka një shtrirje mbi 150m. Mbetjetet janë të sjella nga rrjedha e ujit, kur lumi është në prurjet maksimale të tij. Mbetjet janë të hedhura në të dyja anët e bregut të lumit. Morfologjia e këtij vend-depozitimi është me përbërje urbane, kryesisht mbetje plastike.

KAPITULLI 2.

KOMUNITETI DHE BIZNESET E ZONËS – SJELLJET,
QËNDRIMET DHE PERCEPTIMET E TYRE NË LIDHJE ME
VEND-DEPOZITIMET ILEGALE.

SJELLJET, QËNDRIMET DHE PERCEPTIMET E BANORËVE NË LIDHJE ME VEND-DEPOZITIMET ILEGALE

Për të vlerësuar perceptimin që kanë banorët mbi çështjen e vend-depozitimeve në njësinë administrative rurale Laknas, në afërsi të lumit Ishëm ***u intervistuan 52 banorë të zonës, që përfaqësojnë gjithashtu edhe familjet e tyre.*** 54% e të intervistuarëve i përkisnin gjinisë mashkullore, kurse 46% gjinisë femërore.

TË DHËNAT KRYESORE DEMOGRAFIKE

Duke u bazuar në pyetjet e pjesës së parë të pyetësorit që mundësonin informacion për moshën, arsimin dhe statusin e punësimit të banorëve më poshtë paraqitet një përmbledhje e gjetjeve kryesore. Sipas përgjigjeve të marra, 30% e të intervistuarëve i përkasin moshës 18 deri 39 vjeç, kurse pjesa tjetër (70%) bëjnë pjesë në fashën 40 deri 60 vjeç. Këtë rezultat e përforcon edhe fakti që 80% të të pyeturëve kanë më shumë se 20 vite që banojnë në zonën e Laknasit. Në lidhje me arsimimin e të intervistuarëve, mbi 56% e tyre kanë përfunduar arsimin e mesëm, 23% e tyre arsimin bazë, 15% e tyre arsimin e lartë, dhe 6% e tyre arsimin profesional.

Sa i përket statusit të tyre të punësimit, 31% ishin të punësuar me kohë të plotë, 8% të vetëpunësuar, 2% e tyre të punësuar me kohë të plotë, 31% e tyre ishin të papunë dhe 17% pensionist. Për më shumë informacion lidhur me të dhënat demografike referohuni [Ankes 1](#).

MENAXHIMI I MBETJEVE NË KOMUNITET

Nga rezultatet e pyetësorëve të realizuar me banorët e njësisë së Laknasit ata listuan disa nga problematikat kryesore në lidhje me menaxhimin e mbetjeve. Në tabelën e mëposhtme paraqitet një përmbledhje e gjetjeve kryesore:

Tabela 1. Problematikat mjedisore në njësinë administrative Laknas

Problematikat	Nuk është problem	Ndonjëherë është problem	Problem i rëndësishëm
Ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë	9.6%	13.5%	76.9%
Ndotja e tokës	11.5%	30.8%	57.7%
Djegia e mbetjeve	19.2%	9.6%	71.2%
Mbetje të depozituara përgjatë bregut të lumit	1.9%	15.4%	82.7%
Parazitë, minj, insekte	9.6%	15.4%	75%
Pluhuri	13.4%	23.1%	63.5%
Kundërmimi (Era e keqe)	7.6%	2%	90.4%
Zhurma	28.9%	28.8%	42.3%
Sëmundjet e shkaktuara nga mikroorganizmat	26.9%	9.6%	63.5%


Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Rrjedha e lumit dëmton banorët e Laknasit duke i vështirësuar aktivitetet e tyre në të gjitha fushat e jetës, që nga jetesa e përditëshme, bujqësia e deri tek njësitë e vogla tregtare. Për 90% të banorëve të intervistuar problematika kryesore mbetet era e keqe që vjen nga lumi por jo vetëm. Këtë e konfirmon edhe përqindja e banorëve(83%), që mendojnë mbetjet e hedhura janë shkak kryesor për ndotjen e mjedisit por edhe për pasojat të tjera sic janë sëmundjet e shkaktuara nga mikroorganizmat në depozitime. Problematika të tjera janë cilësia e ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë(75% banorëve e vlerësojnë si problem të rëndësishëm), djegia e mbetjeve(71% e banorëve e vlerësojnë si problem të rëndësishëm) dhe prania e insekteve dhe parazitëve. Si problematika më pak të rëndësishme vlerësohet pluhuri, ndotja e tokës dhe zhurmat.

Kur diskutohet për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, 56% e banorëve të intervistuar nuk kishin dëgjuar më parë, vetëm 44% e tyre kishin informacion si realizohet menaxhimi i tyre. Kjo pjesë e banorëve e kishte marrë këtë informacion kryesisht në media, në internet ose nëpërmjet të afërmerve të tyre.

Tabela 2. Informacion mbi menaxhimin e mbetjeve

A keni dëgjuar më parë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta?	Numri i banorëve	(%)
Po	23	44.2%
Jo	29	55.8%
Totali	52	100%



Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Sikur shihet nga tabela e mëposhtme, pjesa më e madhe e banorëve (69.2%) i hedhin mbeturinat në koshat publik të vendosura pranë zonës së banimit. 13.5% e tyre janë shprehur që vazhdojnë të hedhin mbeturinat anës lumit, kjo për shkak të mungesës së koshave në afërsi të vendbanimit të tyre. Sipas përgjigjeve të banorëve, mbeturinat më të shpeshta që nxjerrin nga shtëpia janë kryesisht letër/karton, plastike dhe qelq. Sa i përket vendgrumbullimit të mbeturinave shtëpiake, 67% e banorëve i hedhin në qeset plastike(67%), 33% e tyre në kosha mbeturinash, asnjë prej tyre nuk i ndan mbeturinat në kosha specifik.

Tabela 3. Vendgrumbullimi i mbeturinave shtëpiake

Ku i hidhni mbeturinat që grumbulloni?	Frekuenca (N)	Përqindja (%)
Në koshat publik	36	69.2%
Anës lumit	7	13.5%
Në rrugë apo përgjatë rrugës	3	5.8%
Në një hapësirë të hapur	2	3.8%
Tjetër	4	7.7%

Totali	52	100%
---------------	----	------

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Shqetësuese në këtë pikë është përdorimi në masë i qeseve plastike, të cilat janë një nga ndotësit kryesor të mjedisit. Sipas dëshmive të banorëve në zonë ka shumë pak kosha publik, të cilët nuk plotësojnë nevojat e familjeve. **Sipas tyre 10 kosha janë të pamjaftueshëm për të grumbulluar mbetjet e 500 familjeve, duhet të paktën 10 kosha për 100 familje. Ky opinion i banorëve bie ndesh me atë të marrë nga Bashkia Kamëz, e cila shprehet se koshat shtohen çdo ditë në rrugët ku është më e nevojshme.**

67% e banorëve të intervistuar kishin kosha publik afër vendbanimit të tyre. Për sa i përket largësisë nga banesa e tyre, 77% e tyre i kishin koshat në distancë kohore 5 deri 15 minuta kurse 23% e banorëve duhet të përshkruante rrugë në këmbë rreth 20 minuta për të hedhur mbeturinat në koshat publik më të afërt (Tabela 6).

Tabela 4. Vendodhja e koshave publik

A ndodhen kosha publik afër vendbanimit tuaj?	Numri i banorëve	(%)
Po	35	67.3%
Jo	17	32.7%
Totali	52	100%

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

40% e banorëve shprehen se ndërmarrja e pastrimit vjen 3 herë në javë për të zbrazur koshat, 23% e tyre kanë vënë re që vetëm 2 herë në javë koshat pastrohen nga ndërmarrja e kontraktuar. 29% e tyre shprehen që ndërmarrja vjen vetëm një herë në javë për të zbrazur koshat në zonën ku banojnë duke krijuar grumbullime të llojeve të ndryshme të mbetjeve, të cilat me kalimin e ditëve vijnë aromë të pakëndëshme por bëhen edhe shkak për grumbullimin e insekteve dhe parazitëve.

Tabela 5. Largësia kohore e koshave publik nga vendbanimi

Nëse PO, Sa minuta larg vendbanimit tuaj ndodhen koshat publik?	Numri i banorëve	Përqindja (%)
5-10 min	25	71.4%
11-15 min	2	5.7%
16-20 min	8	22.9%
Totali	35	100%

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Tabela 6. Shpeshhtësia e zbrazjes së koshave

Nëse PO, Sa shpesh zbrazen koshat e mbeturinave nga ndërmarrja e pastrimit?	Numri i banorëve	Përqindja (%)
1 herë në javë	10	28.6%
2 herë në javë	8	22.9%
3 herë në javë	14	40.0%
Çdo ditë	3	8.5%
Totali	35	100%

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Një pyetje e rëndësishme që ju drejtua banorëve ishte lidhur me vlerësimin që ata kshin për shërbimin e ofruar nga ndërmarrja e pastrimit e kontraktuar nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve. Sipas përgjigjeve, 40% e tyre e vlerësojnë **“Shumë të dobët”** shërbimin e marr nga ndërmarrja e pastrimit, 10% e banorëve si shërbim **“Të dobët”**, 29% e tyre shprehen që shërbimi është **“I mirë”** por ka nevojë për përmirësim sidomos në aspektet si prezencja e më shumë koshave dhe rritja e shpeshhtësisë së qarkullimit në zonë të makinave të pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve (Tabela 8).

Tabela 7. Vlerësimi i banorëve për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve

Vlerësimi i banorëve për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve	Numri i banorëve	Përqindja (%)
Shumë i dobët	21	40.4%
I dobët	5	9.6%
Mesatar	10	19.2%
I mirë	15	28.8%
Shumë i mirë	1	1.9%
Totali	52	100%

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

MENAXHIMI I MBETJEVE NGA BASHKIA KAMËZ


Bashkia Kamëz është përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në njësinë administrative rurale Laknas, por ajo ka dhënë me koncesion pastrimin e bashkisë kompanisë “ALKO-IMPEX General Construcion & 2T”. Banorët e cilësojnë si një nga shqetësimet kryesore nevojën për adresim tek institucionet përgjegjëse të situatës tepër shqetësuese të krijuar nga vendgrumbullimet e shumta të mbetjeve

përgjatë Lumbardhi por edhe zona të banuara. Bashkia Kamëz aplikon për çdo familje të zonës një tarifë pastrimi/gjellërimi 6500 ALL në vit, për të cilën banorët e intervistuar kishin informacion që duhej paguar por gjysma e tyre nuk di çfarë shërbimesh përfitonin nga pagesa e kësaj tarife. Vetëm 33% e banorëve u shprehën që në këtë tarifë përfshihej grumbullimi dhe transporti i mbetjeve, kurse 17% e tyre kishin informacionin më të saktë duke ditur që ndërmarrja bën edhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve të grumbulluara.

Tabela 8. Shërbimet që mbulon tarifa e gjellërimin

A keni dijeni për shërbimet që mbulohen përmes tarifës së pastrimit/gjellërimin?	Numri i banorëve	(%)
Po, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve	17	32.7 %
Po, grumbullimi, transporti dhe trajtim përfundimtar i mbetjeve	9	17.2 %
Nuk e di	26	50%
Totali	52	100%

A keni dijeni për tarifën e pastrimit që aplikon bashkia Kamëz?



Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Në lidhje me mënyrën sesi paguhet kjo tarifë, 56% e banorëve u shprehën se fatura për pagesën e kësaj tarife lëshohet nga Bashkia dhe duhet të paguhej një herë në vit. Si paraqitet në tabelën e mëposhtme, 29% e banorëve të intervistuar nuk kishin informacion sesi të merrnin faturën për të paguar tarifën e pastrimit, pjesa tjetër e paguanin tarifën e pastrimit si pjesë të faturës së ujit (15%).

Tabela 9. Mënyrat e pagesës së tarifës së pastrimit

Si paguhet kjo tarifë	Numri i banorëve	Përqindja (%)
Është pjesë e faturës së ujit	3	7.7%
Fatura lëshohet në zyrën e bashkisë	29	55.8%
Nuk e di	15	28.8%
Tjetër	4	7.7%
Totali	52	100%

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Pyetja tjetër e drejtur merr informacion nëse kjo tarifë paguhet nga të gjithë banorët apo në rastet ku atyre i duhet të përfitojnë nga shërbimet e Bashkisë. **75% e banorëve të intervistuar e paguanë tarifën e pastrimit rregullisht.** Sipas përgjigjeve të dhëna, 33% e tyre e paguanë rregullisht një herë

në vit tarifën, 17% e paguajnë tarifën vetëm nëse i duhet ndonjë shërbim tjetër nga Bashkia, 15% e paguajnë ndonjëherë vullnetarisht dhe vetëm 25% e banorëve të intervistuar nuk e paguajnë tarifën kjo për arsyen kryesore që nuk e përballojnë dot ekonomisht, por edhe sepse nuk marrin shërbim nga ana e bashkisë.

Tabela 10. Pagesa e tarifës së pastrimit

A e paguani tarifën e pastrimit?	Numri i banorëve	Përqindja (%)
Po, e paguaj çdo muaj, me faturën e ujit	5	9.6%
Po, e paguaj rregullisht, një herë në vit, vullnetarisht	17	32.7%
Po, e paguaj vetëm kur kam nevojë për shërbime administrative nga bashkia	9	17.3%
E paguaj ndonjëherë vullnetarisht	8	15.4%
Nuk e paguaj	13	25.0%
Totali	52	100%

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Situata aktuale e menaxhimit të mbetjeve në njësinë administrative Laknas

Për të vlerësuar situatën aktuale të menaxhimit të mbetjeve në zonë por edhe për të parë sesi ka qënë ndërhyrja e institucioneve përgjegjëse në rastet kur situata ju është bërë e ditur nëpërmjet mjeteve ligjore si ankesat apo kërkesës për informacion janë drejtur një sërë pyetje banorëve, përgjigjet e tyre paraqiten të përmbledhura në tabelat e mëposhtme.

Tabela 11. Situata aktuale e menaxhimit të mbetjeve në zonën e studimit

Si paraqitet situata aktuale e menaxhimit të mbetjeve në zonën tuaj ?	Numri i banorëve	Përqindja (%)
Shqetësuese	24	46.2%
Ka vend-grumbullime mbeturinash, por ndodhen larg vendbanimit tim	17	32.7%
Nuk pronocohem për situatën	11	21.2%
Totali	52	100%

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Për 79% të banorëve të intervistuar situata paraqitet shqetësuese, me vendgrumbullime mbetjesh të ndryshme, vetëm 21% e banorëve nuk pranuan të pronocohen për situatën. Banorëve të cilët janë përgjigjur dy opsioneve të para, ju janë disa pyetje në lidhje me mjetet e ankesës për të bërë të ditur

pranë institucioneve përgjegjëse gjendjen aktuale të menaxhimit të mbetjeve, këtu përfshihet administratori i njësisë dhe Bashkia Kamëz. Sipas përgjigjeve të marra nga banorët të cilët janë drejtur të paktën një herë njësisë administrative për të marr një zgjidhje për keqmenaxhimin e mbetjeve, njësia ka marr ankesën e tyre por nuk i ka dhënë zgjidhje problemit të paraqitur. Përveç faktit që bashkia nuk ka marr masa për përmirësimin e situatës, banorët shprehen që nuk kanë marr një përgjigje përse kërkesa e tyre nuk ka marr përgjigje dhe nuk ka kaluar në fazën e shqyrtimit nga komisioni i ankimit apo në fazën përfundimtare që është ngritja e një taskforce për zgjidhjen e problematikës.

Për të kuptuar më mirë kush është përgjegjësi kryesor për keqmenaxhimin e mbetjeve në njësinë administrative Laknas, banorëve ju është drejtuar pyetja ***“Kush mendoni se është përgjegjës për situatën e vend-grumbullimeve përgjatë lumit Ishëm dhe zonës përreth”***. 83% e banorëve ja delegojnë këtë përgjegjësi Bashkisë Kamëz, vetëm 15% shprehen se edhe banorët e zonës duhe të jënë më të përgjegjshëm në menaxhimin e mbetjeve. Nga opinionet e hapura të banorëve, rezulton se rruga e vetme për të gjetur një zgjidhje për situatën është krijimi i urave të komunikimi midis tyre dhe Bashkisë Kamëz. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet dialogut të përbashkët dhe jo hedhjes së fajit nga njëra anë në anën tjetër.

Tabela 12. Përgjegjësi për situatën aktuale të keqmenaxhimit të mbetjeve në zonën e studimit

	Numri i banorëve	Përqindja (%)
Banorët	8	15.4%
Bashkia Kamëz	43	82.7%
Tjetër (të dyja palët)	1	1.9%
Totali	52	100%

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

SJELLJET, QËNDRIMET DHE PERCEPTIMET E BIZNESEVE NË LIDHJE ME VEND-DEPOZITIMET ILEGALE

Për të vlerësuar menaxhimin e mbetjeve në zonën e Laknasit, në afërsi të lumit Ishëm **u intervistuan 10 biznese**, të cilët përfshiheshin në madhësinë e bizneseve të vogla dhe të mesme. Konkretisht 7 biznese i përkisnin kategorisë “Biznes i vogël” dhe 3 biznese kategorisë “Biznes i mesëm”. Bizneset kryenin aktivitete ekonomike në shitje me pakicë dhe shumicë, shërbime si bar dhe restorant, fasoneri dhe servis makinash. Mesatarisht të gjitha bizneset kishin më shumë se 5 vite që operonin në treg.

Përfaqësuesve të bizneseve ju drejtuan disa pyetje, kryesisht të lidhura me ceshtjen e menaxhimit të mbetjeve nga bashkia Kamëz dhe nga vet komuniteti. Një nga pyetjet e drejtuara kishte të bënte me problematikën e menaxhimit të mbetjeve në zonën ku operonte biznesi, dhe përgjithësisht të gjithë ishin dakord që **problematika kryesore lidhej me mungesën e koshave publik në afërsi të bizneseve dhe mospastrimi i koshave në mënyrë sistematike**. Problematika të tjera lidhen me cilësinë e ujit që vjen nga rrjeti i kanalizimeve, era e keqe nga vendgrumbullimet afër bizneseve, zhurmat, prezenca e parazitëve dhe insekteve sidomos gjatë stinës së verës.

Të gjithë të intervistuarit nuk kishin informacion në lidhje me deponimin e mbetjeve. Kur i pyetëm në lidhje me shpeshësinë e pastrimit të koshave përgjigjet më të shpeshta ishin 2 herë ose 3 herë në javë vjen makina e pastrimit. **Bizneset në ambjentet e tyre nuk i ndanin mbetjet sipas llojit të tyre, kjo si pasojë e kostos së koshave**. Sipas tyre ndërmarrja e pastrimit nuk i ndan mbetjet sipas llojeve, dhe kjo ndarje nga ana jonë është e pavlefshme. Kryesisht këto biznese gjeneronin mbetje të llojit si letër/karton, plastikë (shishe/qese) dhe ushqime.

Pyetje e rradhës e drejtuar përfaqësuesve ishte **“A mendoni se mënyra e grumbullimit të mbetjeve në zonën tuaj është e duhura?”**. Për këtë pyetje të gjitha përgjigjet ishin të njëjta “JO”. Sipas tyre Bashkia Kamëz në bashkëpunim me kompaninë e pastrimit duhet të marrin masa të menjëhershme për rritjen e numrit të koshave publik, pastrimin e vend-grumbullimeve të mbetjeve pranë bizneseve por edhe përgjatë lumit Ishëm.

Sa i përket tarifës që Bashkia aplikon për pastrim/gjelbërimin, **të gjithë bizneset e paguanin rregullisht në vit por përfaqësuesit pohuan që shuma nuk justifikon shërbimin që ata marrin, duke e konsideruar shumë të lartë**. Në lidhje me efektet ekonomike, përfaqësuesit e bizneseve u shprehën se keqmenaxhimi i mbetjeve nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në ecurinë e biznesit të tyre. **Por ka raste sidomos në bizneset që ofrojnë shërbime, prania e mbetjeve në zonë bëhet shkak për largimin e klientëve**, të cilët refuzojnë të konsumojnë ushqim ose kafe duke parë vend-grumbullim e mbetjeve, koshat e tejmbushur me mbetje apo edhe erën e keqe që vjen në zonë. Për këto problematika bizneset janë drejtuar në njësisë administrative për të gjetur një zgjidhje, në disa raste kanë marr përgjigje dhe problemi është zgjidhur por ka edhe raste kur problemi nuk është zgjidhur.

Përfaqësuesit e njësive ekonomike shprehen që edhe ata duhet të marrin masa për të shtuar koshat e mbeturinave në mjediset e brendshme dhe të jashtme të punës.

Të intervistuarit i sygjerojnë Bashkisë Kamëz marrjen e këtyre masave:

1. Shtimin e koshave publik në afërsi të bizneseve;
2. Pastrimin e mbetjeve në vend-grumbullimet afër bizneseve;
3. Ndërhyrje përgjatë Lumit Ishëm dhe ndalimin e hedhjes së mbetjeve duke përdorur metoda të ndryshme (si për shembull, dialogu me banorët dhe bizneset);
4. Shtimi i hapësirave të gjelbra në zonë por edhe përgjatë Lumit Ishëm.

KAPITULLI 3.

PASOJAT NË SHËNDET DHE MJEDIS NGA VEND- DEPOZITIMET ILEGALE.

HYRJE

Në situatat kur kemi prezencë të vend-depozitimeve të mbetjeve përgjatë lumenjeve, mjedisi më i prekur është ai ujqor. Për shkak të morfologjisë të këtyre vend-depozitimeve, mbetjet që përmbajnë kimikate si dhe prezencë të ujërave të patrajuara në ujërat sipërfaqësore, mund të kontaminojnë pusët dhe ujin sipërfaqësor të përdorur si burim i ujit të pijshëm. Për këtë arsye, pjesë e rëndësishme e pyetësoreve ishte edhe marrja e opinioneve të banorëve në lidhje me çështjen e cilësisë së ujit që ata konsumojnë, si dhe të dhëna në lidhje me problemet shëndetsore që banorët apo familjarët e tyre kanë.

SJELLJET, QËNDRIMET DHE PERCEPTIMET E BANORËVE NË LIDHJE ME CILËSINË E UJIT

Sipas informacionit të marrë nga Bashkia Tiranë, njësia e Laknasit aktualisht furnizohet me puse individuale dhe me ujë me botë. Zona ka mungesë në furnizimin me ujë të pijshëm pasi rrjeti aktual që i shërben kësaj zone është në gjendje të amortizuar dhe nuk plotëson kërkesat që paraqet kjo zonë.

Për këtë arsye Ujësjiellës Kanalizime Kamëz ka bërë kërkesë Agjencisë Kombetare të Ujësjiellës-Kanalizime dhe Infrastruktursë së Mbetjeve për financimin e investimit për një projekt zbatimi në këtë zonë, e cila nuk i ka kthyer një përgjigje.

Kjo problematikë është ngritur edhe nga banorët e zonës së Laknasit gjatë fazës së intervistimit. Sipas banorëve të intervistuar, 79% e tyre e blenin ujin, 19% kishin pusin si burim kryesor dhe vetëm 2% e tyre e merrnin ujin nëpërmjet rrjetit të ujësjiellës kanalizimeve.

Tabela 13. Niveli i kënaqësisë për furnizimin me ujë

Cili është niveli juaj i kënaqësisë për furnizimin me ujë?	Numri i banorëve	(%)
I pakënaqur	35	67.3
I kënaqur	17	32.7
Totali	52	100%

Burimi: Vlerësimi i RESU, 2022

Të pyetur për nivelin e kënaqësisë për furnizimin me ujë, 67% e tyre shprehën **“Të pakënaqur”** kurse 33% janë **“Të kënaqur”**. Banorët që u shprehen të pakënaqur me furnizimin me ujë të pijshëm ju drejtua një pyetje në lidhje me arsyen e këtij pohimi. 43% e tyre mendojnë që uji që vjen është i dëmshëm për shëndetin, 26% e tyre shprehën që uji vjen në orar të kufizuar, ndërkohë 20% shprehet që nuk kanë burim uji nga rrjeti, për këtë arsye kanë hapur puse. 6% e banorëve nuk mund të përballojnë koston e lartë të ujit të blërë kurse 6% e tyre janë shprehur të pakënaqur me furnizimin me ujë sepse uji që vjen ka shije dhe aromë të keqe.




Figura 3. Arsyet e pakënaqësisë lidhur me furnizimin me ujë
Burimi: Ilustrim i autorëve

Një pyetje tjetër që ju drejtua banorëve kishte të bënte me sëmundjet kronike që mund të ketë pasur personi i intervistuar apo ndonjë familjar së fundmi. 53% e banorëve u shprehën që së fundmi as ai/ajo apo ndonjë familjar kanë vuajtur nga ndonjë sëmundje. Për pjesën e mbetur të cilët pohuan që kishin vuajtur nga një sëmundje, banorët ishin diagnostifikuar me sëmundje në rruget respiratore, alergji apo edhe kishin pasur dhimbje koke.

Tabela 14. Sëmundjet kronike

Sëmundjet kronike	Numri i banorëve	(%)
Probleme me rrugët respiratore	14	58.3%
Probleme me stomakun	2	8.3%
Dhimbje koke	5	20.8%
Tjetër (Alergji, Teroide)	3	12.5%
Totali	24	100%

CILËSIA E UJIT PËR KONSUM NGA NJERËZIT

Nga intervistat e ndryshme të bëra me familjarët e zonës së Laknasit dolëm në përfundimin se burimi kryesor i furnizimit me ujë është ai nëntokësor, pra ujë pusi. Gjithashtu, gjatë vizitës sonë në terren problematika kryesore që kishin banorët përveç ndotjes së basenit të lumit ishte dhe cilësia e ujit, ku ato ankoreshin për aromën e keqe, fortësinë dhe ngjyrën e ujit.

Sa e rëndësishme është siguria e ujit që përdorim?

Sëmundjet e lidhura me ujin mbeten një nga shqetësimet më kryesore shëndetësore në botë. Sëmundjet diarreike, të cilat rrjedhin kryesisht nga konsumimi i ujit jo të pastër. Prandaj, është jetike që cilësia e ujërave nëntokësore të mbrohet. Për më tepër, akuiferët shpesh mbrohen mirë nga shtresat e tokës dhe sedimentit, të

cilat filtrojnë në mënyrë efektive ujin e shiut ndërsa depërton nëpër to, duke hequr kështu grimcat, mikroorganizmat patogjenë dhe shumë përbërës kimike. Megjithatë, ky proces i filtrimit natyror mund të mos jetë i mjaftueshëm për të hequr të gjithë ndotësit. Uji nëntokësor kontaminohet lehtësisht dhe bëhet shkak për përhapjen e sëmundjeve nga burimet e ndryshme të ndotjes. Mungesa e një furnizimi të sigurt me ujë ndikon në shfaqjen e sëmundjeve, si dhe duke kufizuar mundësitë e përdorimit të tij për higjienën personale dhe shtëpiake. Prezenca e kolonive bakteriologjike në ujin e konsumueshëm është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e cilësisë së ujit dhe rrezikut për shëndetin e njeriut nga infeksioni. Më poshtë janë paraqitur simptomat në shëndet në rast kontaminimi nga bakteret apo viruset e mëposhtme.

Tabela 15. Simptomat në shëndet të prezencës së baktereve/viruseve në ujin e pijshëm.

Bakteri/Virusi	Simptomat	Shfaqja e simptomave	Origjina
Escherichia Coli	Marrje mendsh, të vjella, dhimbje abdominale dhe diarre.	Simptomat shfaqen nga dita e 1 në të 8.	Uji kontaminohet nga feçet e njerëzve apo kafshëve.
Campylobacter Jejuni	Dhimbje muskujsh, dhimbje trupi, ethe dhe diarre.	Simptomat shfaqen nga 2 deri në 10 ditë pas ekspozimit me këtë bakter.	Uji kontaminohet nga feçet e njerëzve apo kafshëve.
Hepatitis A	Urinë e errët, dhimbje muskujsh, verdhëz, dhimbje stomaku, ethe dhe këputje.	Hepatitis A ka një periudhë të gjatë inkubimi dhe simptomat mund të mos shfaqen deri në 28 ditë.	Uji i kontaminuar nga jashtëqitjet e një personi të infektuar, nga disa lloje ushqimesh dhe kontakti i drejtpërdrejtë me një person të infektuar.
Giardia Lamblia	Marrje mendsh, gazra, dhimbje muskujsh dhe diarre.	Periudha e inkubimit është 2 javë.	Uji kontaminohet nga jashtëqitjet e njerëzve apo kafshëve të infektuara.
Salmonella	Të dridhura, dhimbje trupi, dhimbje koke, diarre dhe ethe.	Shfaqen nga 1 deri në 3 ditë pas konsumimit.	Salmonella zakonisht gjendet në sistemin tretës të kafshëve, përfshirë dhe zogjtë. Njeriu mund të infektohet nga ushqimi ose nga uji i kontaminuar me feçet e kafshëve.
Legionella Pneumophila	Ethe, marrje fryme, kollë dhe dhimbje muskujsh.	Shfaqen nga 2 deri në 10 ditë nga kontakti me këtë bakter.	Ky bakter gjendet në ujë dhe në ajër.

⁷ [2006 World Health Organization. Protecting Groundwater for Health: Managing the Quality of Drinking-water Sources. Edited by O. Schmoll, G. Howard, J. Chilton and I. Chorus. ISBN: 1843390795. Published by IWA Publishing, London, UK.]

Cryptosporidium	Diarre të vazhdueshme dhe të dhembshme.	Shfaqen nga 2 deri në 10 ditë.	Kontaminon ujin e pijshëm. ⁸
Vibrio cholerae (Kolera)	Diarre, marrje mendsh, vjellje, dehidratim, dhimbje muskujsh, gjendje shoku.	Simptomat shfaqen nga 2 orë deri në 5 ditë.	Uji i pijshëm i pa trajtuar
Shigellosis	Diarre, dhembje barku, marrje mendsh, te vjella. Gjithashtu shpesh personat e infektuar kane gjak apo mucus ne jashteqitjen e tyre.	Simptomat shfaqen nga 1 deri ne 2 dite.	Uji i pijshem i kontaminuar nga jashteqitjet e personave te infektuar. ⁹
Yersinia enterocolitica	Dhembje barku, ethe dhe diarre që shpesh shoqërohet dhe me gjakderdhje.	Simptomat shfaqen nga 4 deri në 7 ditë nga kontakti fillestar.	Ky bakter gjendet tek kafshët por transmetohet tek njeriu nga kontaminimi i ujit të pijshëm (Zakonisht nga derrat). ¹⁰
Listeria monocytogenes	Simptoma të lehta: Ethe, diarre, dhimbje muskujsh, marrje mendsh, të vjella. Simptoma të rënda: Dhimbje koke, konfuzion, kufizim lëvizjeje të qafës, konvulsione dhe humbje ekuilibri.	Simptomat shfaqen nga pak orë deri në 3 ditë nga kontaminimi.	Uji kontaminohet nga njerëzit dhe kafshët e infektuara. Gjithashtu ky bakter mund të gjendet në shumë ushqime. ¹¹

CILËSIA E UJIT TË PUSEVE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RURALE LAKNAS

Duke iu referuar situatës me të cilën u përballëm në zonë pilot, si dhe me shqetësimet e familjarëve, për të përcaktuar cilësinë e ujit që konsumohet nga banorët e zonës Laknas, ishte e nevojshme kryerja e analizave baktereologjike për të parë se sa i konsumueshëm është realisht ky ujë.

⁸ Team, N. B. (2018, May 4). 7 Examples of Harmful Bacteria Found in Water. Microbiological Testing | Food & Water Testing | Nova Biologicals. <https://www.novatx.com/antimicrobial-testing/7-examples-of-harmful-bacteria-found-in-water/>

⁹ Coliform Bacteria—An overview | ScienceDirect Topics. (n.d.). Retrieved January 31, 2022, from <https://www.sciencedirect.com/topics/agricultural-and-biological-sciences/coliform-bacteria>

¹⁰ Government of Ontario, M. of H. and L.-T. C. (n.d.). Yersiniosis—Diseases and Conditions—Publications—Public Information—MOHLTC. Government of Ontario, Ministry of Health and Long-Term Care. Retrieved January 31, 2022, from <https://www.health.gov.on.ca/en/public/publications/disease/yersiniosis.aspx>

¹¹ Nutrition, C. for F. S. and A. (2022). Listeria (Listeriosis). FDA. <https://www.fda.gov/food/foodborne-pathogens/listeria-listeriosis>

Për analizimin e ujit u vendos marrja e mostrave në 7 pika të ndryshme mostrimi në Laknas. Nga këto 7 pika, 6 ishin shtëpi private dhe një biznes. Mostra e ujit është marrë nga uji i puseve që janë në përdorim nga banorët. Kampionimi është bërë mbi bazë të procedurës së mostrimit. Shpërndarja e pikave të marrjes së kampionëve ishte rastësore dhe përfaqësuese. Me poshtë janë paraqitur të dhënat specifike të shprehura në hartë dhe në tabelë.

Figura 4. Lokacioni i stacioneve të mostrimit për analizat e ujit



Burimi: Ilustrim i autorëve

Tabela 16. Të dhënat për analizat e ujit

Nr.	Kodi	Analiza	Vlera	Njësia	Niveli Maksimal i Ndotësit (MCL) - Sipas standarteve të OBSH ¹²	Metoda e Analizës	Data e kampionimit	Kordinatat	Thellësi
1	M1	Total Coliforme	18	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016	09.02.2022	41,36736°N 19,75713E	8 m
		E-Coli	0	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016			
2	M2	Total Coliforme	2	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016	09.02.2022	41.379296N 19.736929E	30 m
3	M3	Total Coliforme	1	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016	09.02.2022	41.380880N 19.736160E	30 m
4	M4	Total Coliforme	300	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016	09.02.2022	41.378726N 19.73583E	85 m
		E-Coli	104	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016			
5	M5	Total Coliforme	95	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016	09.02.2022	41.375989N 19.741247E	30 m
		E-Coli	0	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016			

¹² http://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/40025/European_standards_for_drinking_water.pdf;jsessionid=8EE167161B3540414F429343F7597DF8?sequence=1

6	M6	Total Coliforme	26	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016	09.02.2022	41.373963N 19.739638E	30 m
7	M7	Total Coliforme	846	N°/100ml	Absent	ISO 9308-1:2014/AMD 1:2016	09.02.2022	41.3735030N 19.739E	30 m

Raporti i analizave ndodhet bashkëngjitur në Aneksin 4

Nga rezultatet e marra vëmë re se në të gjitha kampionet kemi prani të koliformeve totale. Përveç kësaj, rezultojnë që një nga stacionet është me prezencë shumë të lartë të *Escheria Coli*. Kampionet e ujit janë marë të shpërndara përgjatë basenit të lumit, me një largësi mesatare 196m dhe me një thellësi mesatare prej 34.7m thellësi. Këto vlera tregojnë se në ujërat nëntokësore ka prezencë të kolonive mikrobiologjike duke e kualifikuar ujin si të PA KONSUMUESHËM.

Nëse *E.Coli* është i pranishëm në ujë, do të thotë se ka pasur ndotje fekale të kohëve të fundit. Nëse *E.Coli* mungon, por janë të pranishëm vetëm koliformet totale, mund të nënkuptojë një nga tre gjërat:

- Një shtresë bakteresh mund të jetë zhvilluar brenda pusit ose sistemit tuaj të tubave.
- Uji sipërfaqësor mund të hyjë në pusin tuaj. Kjo rrit rrezikun që mbetjet e kafshëve të ndotin ujin tuaj herët a vonë.
- Uji i pusit tuaj mund të vijë nga një akuifer që përmban baktere. Kjo mund të ndodhë kur vijnë ujërat nëntokësore nga një burim i cekët.¹³

Në rastin konkret, baseni i Lumit Ishëm është tejet i ndotur si nga mbetje të ndryshme të hedhura pa kriter, si dhe nga derdhja e ujërave të zeza në këtë lumë. Mungesa e infrastrukturës së duhur për menaxhimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, si dhe mungesa e sistemit të ujësjellësit, për ujin e pijshëm, është një nga faktorët me peshë jo të vogël në këtë situatë me të cilët banorët e zonës Laknas janë të detyruar të përballen çdo ditë.

Në këto kushte është e rëndësishme që uji të mos përdoret për higjienën personale dhe atë të kuzhinës. Duhet të njoftohen instancat kryesore për paraqitjen e problemit, që këta të fundit të marrin masat e nevojshme për zgjidhjen e problemit duke bërë pastrimin e puseve, që mund të jetë zgjidhja më e shpejtë dhe e përkoshme, ose duke ngritur infrastrukturën e menaxhimit për ujërat e zeza dhe atë të pijshëm.

¹³<https://www2.gnb.ca/content/dam/gnb/Departments/hs/pdf/en/HealthyEnvironments/water/Coliforme.pdf>

8. PËRFUNDIME

Përfundimet e këtij raporti nisur nga qëllimi e këtij raporti, janë si më poshtë:

1. *Analizimi i situatës ekzistuese të vend-depozitimeve ilegale nëpërmjet identifikimit në terren dhe hartëzimit të tyre.*

Nga rezultatet e marra janë identifikuar **11 vend-depozitime ilegale burim**. Mbetjet e grumbulluara në vend-depozitimet ilegale burim kanë një përbërje të larmishme morfologjike, ku dominon mbetjet urbane, (plastika, qelqi, mbetje organike etj.) mbetje inerte, metali, si dhe objekteve të tilla si: gomat, pajisje dhe mobilje. Ky tregues tregon një përkeqësim të situatës nga ajo çfarë është identifikuar në vitin 2020. Nga vëzhgimet në terren konstatohen zjarrëvënie të qëllimshme të këtyre vend-depozitimeve.

2. *Njohja e perceptimeve të grupeve të interesit (Banorët, Biznese, si dhe Institucioneve vendore) mbi problemin e vend-depozitimeve, shkaktarët si dhe pasojat e këtyre problemeve.*

- a) **79% e banorëve të intervistuar theksuan që situata paraqitet shqetësuese**, me vend-depozitimet përgjatë lumit, vetëm 21% e banorëve nuk pranian të pronocohen për situatën.
- b) **Pjesa më e madhe e banorëve (69.2%) i hedhin mbeturinat në koshat publik të vendosura pranë zonës së banimit**. 13.5% e tyre janë shprehur që vazhdojnë të hedhin mbeturinat anës lumit, kjo për shkak të mungesës së koshave në afërsi të vend-banimit të tyre.
- c) **67% e banorëve të intervestuar kishin kosha publik afër vendbanimit të tyre**. Për sa i përket largësisë nga banesa e tyre, për 77% e tyre i kishin koshat në distancë kohore 5 deri 15 minuta.
- d) **83% e banorëve ja delegojnë këtë përgjegjësi Bashkisë Kamëz**, vetëm 15% shprehen se edhe banorët e zonës duhet të jenë më të përgjegjshëm në menaxhimin e mbetjeve. Nga opinionet e hapura të banorëve, rezulton se rruga e vetme për të gjetur një zgjidhje për situatën është krijimi i urave të komunikimit midis tyre dhe Bashkisë Kamëz.
- e) Problematika kryesore e evidentuar nga intervistat me përfaqësuesit e bizneseve ishte **mungesa e koshave publik në afërsi të bizneseve dhe mospastrimi i koshave në mënyrë sistematike**.
- f) Sa i përket tarifës që Bashkia aplikon për pastrim/gjelbërimin, **të gjithë bizneset e paguanin rregullisht në vit, por përfaqësuesit pohuan që shuma nuk justifikon shërbimin që ata marrin, duke e konsideruar shumë të lartë**

3. *Analizimin e pasojave në shëndet dhe mjedis nga vend-depozitimet ilegale.*

- a) 53% e banorëve u shprehen që se fundmi ai/a apo ndonjë familjar kanë vujtur nga ndonjë sëmundje kornike dhe kryesisht e rrugëve respiratore (58.3% e të intervistuarve)
- b) 100 % të kampioneve të ujit të puseve të analizuar tregojnë prezencë të koliformeve totale, tregues i ndotjes të këtij uji, duke e klasifikuar këtë ujë si **të pa - konsumueshëm**. (Bazuar në standartet e OBSHs, Uji i konsumueshëm nuk duhet të ketë prezencë të total koliformeve).

9. REKOMANDIME

Në këtë seksion do të jepen disa rekomandime sesi mund të zgjidhen nevojat dhe problematikat e evidentuara.

Problemi 1: a) Prezenca e 11 vend-grumbullimeve burim përgjatë Lumit të Tiranës në njësinë Administrative Rurale Laknas.

Rekomandimi: Hartimi i një plani “Mbyllje dhe Rehabilitimi të vend-depozitimeve Ilegale në NJAR Lakanas”. Ky plan duhet të bazohet në përshkrimet për secilin nga vend-depozitimet në këtë material si dhe bazuar në: Ligje, Udhëzime, VKM, si dhe në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.

b) Mungesa e një plani lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Kamëz

Rekomandimi: Ligji i instrukton qeveritë vendore të hartojnë dhe miratojnë kuadrin e nevojshëm rregullator lokal. Kuadri lokal përfshin rregulloret e ndryshme që përcaktojnë proceset e menaxhimit të mbetjeve dhe objektin, përshkruajnë indikatorët, specifikojnë kriteret dhe instruktojnë strukturat lokale në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve, si dhe në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin. I rekomandohet Bashkisë Kamës të marrë masa për hartimin e një plani të ri të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve sipas ligjeve përkatëse.

Problemi 2: Niveli i ulët i ndërgjegjësimit tek banorët apo Bizneset e Zonës

Rekomandimi: Të përforcohet norma sociale se hedhja e mbetjeve në mënyrë të paligjshme është e papranueshme. Nëpërmjet bashkëpunimit me organizata apo nëpërmjet takimeve në terren me banorë për ndërgjegjësimin në lidhje me ndalimin e këtij fenomeni.

Rekomandimi: Pushteti vendor duhet të shtojë kontrollin dhe survejimin pranë vend-depozitimeve. Vendosja në dispozicion të një numëri Jeshil pranë Policisë Bashkiake, ku qytetarët mund të denoncojnë rastet e hedhjes së mbetjeve në mënyrë të paligjshme. Të merren masa Administrative dhe penale kundrejt ndotësve.

Problemi 3: Mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve pranë vendbanimeve dhe bizneseve të njësisë Laknas

Rekomandimi: Bashkia Kamëz duhet të shtojë kontenerët publik afër vendbanimeve dhe biznese duke përfshirë të gjithë territorin e njësisë Laknas. Bllokimin e hapësirave që të çojnë në vend-depozitimet ekzistuese, si dhe vendosja e sinjalistikave paralajmëruese të parimit “Ndotësi paguan” (Parimet e Kushtëtutës së Shqiperise). Shtimi i hapësirave rekreative përgjatë Lumit.

Problemi 4: Mungesa e rrjetit të Ujësjellës – Kanalizimeve dhe ndotja e ujit të puseve

Rekomandimi: Rekomandohet që qeverisja vendore të marrë masa të menjëhershme për furnizimin e banorëve me ujë të pijshëm. Kjo shihet si diçka emergjente, nisur nga rezultatet e marra në këtë material. Rekomandohet që banorët të shmangin aq sa është e mundur përdorimin e ujit të puseve (duke përfshirë edhe përdorimin për higjenë personale, gatim, larje fruta/perime etj.), ose ky ujë të kalojë në vlim përpara përdorimit.

ANEKSE

ANEKS 1.TË DHËNA DEMOGRAFIKE TË BANORËVE TË INTERVISTUAR

Gjinia	Fekuenca (N)	Përqindja (%)
Femër	24	46.2%
Mashkull	28	53.8%
Totali	52	100%

Mosha	Fekuenca (N)	Përqindja (%)
18-28 vjeç	7	13.5%
29-39 vjeç	7	13.5%
40-50 vjeç	14	26.9%
51-60 vjeç	12	23.1%
Mbi 60 vjeç	12	23.1%
Totali	52	100%

Niveli i arsimimit	Fekuenca (N)	Përqindja (%)
Shkollë e Mesme	29	55.8%
Shkollë Profesionale	3	5.8%
Arsim i lartë	8	15.4%
Tjetër	12	23.1%
Totali	52	100%

Statusi i punësimit	Fekuenca (N)	Përqindja (%)
Student	6	11.5%
Punonjës me orar të plotë	16	30.8%
Punonjës me kohë të pjesshme	1	1.9%

I/E vetëpunësuar	4	7.7%
Pensionist	9	17.3%
I/E papunë	16	30.8%
Totali	52	100%

Sa kohë keni që banoni në këtë zonë?	Fekuenca (N)	Përqindja (%)
1-2 vite	1	1.9%
3-4 vite	1	1.9%
5-9 vite	1	1.9%
10-19 vite	7	13.5%
mbi 20 vite	42	80.8%
Totali	52	100%

Pjestarë në familjë	Fekuenca (N)
Minimalisht	1
Maksimalisht	8
Mesatarisht	5
Totali	52

ANEKS 2. PYETËSORI DREJTUAR BANORËVE

Të dashur pjesëmarrës,

Unë quhem _____, vullnetar/e pranë Enforce Albania. Ky pyetësor është pjesë e projektit “Metamorfoza e lumit Ishëm-Itinerari i së nesërme”, i cili zbatohet në Bashkinë Kamëz dhe mbështetet financiarisht nga Lëviz Albania. Ky pyetësor do të zgjasë jo më shumë se 10 minuta. I gjithë informacioni që ju do të ndani me ne, do të jetë i rëndësishëm për të kuptuar nevojat e banorëve lidhur me aspekte mjedisore, shëndetësore dhe ligjore të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në zonën e studimit. Të dhënat e marra nga ky pyetësor do të trajtohen si informacion konfidencial dhe do të jenë të disponueshme vetëm për kryerjen e studimit.

Pjesëmarrja juaj në këtë vlerësim është tërësisht vullnetare. Ju lutemi përgjigjuni secilës pyetje me vërtetësi, në mënyrë që të dhënat që do të mbledhim të paraqesin situatën reale.

Pranon të intervistohet ☐ Nuk pranon të intervistohet ☐

I. TË DHËNAT DEMOGRAFIKE**A1. Gjinia juaj?**

☐ Femër ⁽¹⁾

☐ Mashkull ⁽²⁾

A2. Mosha juaj?

☐ 18-28 vjeç ⁽¹⁾

☐ 29-39 vjeç ⁽²⁾

☐ 40-50 vjeç ⁽³⁾

☐ 51-60 vjeç ⁽⁴⁾

☐ mbi 60 vjeç ⁽⁵⁾

A4. Cili është niveli më i lartë i arsimimit që keni kryer?

- ☐ Shkollë e Mesme ⁽¹⁾
- ☐ Shkollë Profesionale ⁽²⁾
- ☐ Arsim i lartë ⁽³⁾
- ☐ Arsim Pas-universitar ⁽⁴⁾
- ☐ Tjetër, _____ specifikoni _____ ⁽⁵⁾

A5. Sa kohë keni që banoni në këtë zonë?

- ☐ Me pak se 1 vit ⁽¹⁾
- ☐ 1-2 vite ⁽²⁾
- ☐ 3-4 vite ⁽³⁾
- ☐ 5-9 vite ⁽⁴⁾
- ☐ 10-19 vite ⁽⁵⁾
- ☐ më shumë se 20 vite ⁽⁶⁾

A3. Statusi i punësimit?

- ☐ Një student ⁽¹⁾
- ☐ Punonjës me orar të plotë ⁽²⁾
- ☐ Një punonjës me kohë të pjesshme ⁽³⁾
- ☐ Të vetëpunësuar ⁽⁴⁾
- ☐ Pensionisti ⁽⁵⁾
- ☐ Aktualisht i papunë ⁽⁶⁾
- ☐ Tjerë, specifikoni _____ ⁽⁷⁾

II. MENAXHIMI I MBETJEVE NË KOMUNITET

B1. Cilat janë problematikat tuaja kryesore në lidhje me situatën mjedisore dhe shëndetësore në zonën ku ju banoni? Ju lutem vlerësoni nga 1 deri ne 5 pike, sipas rëndësisë që ju mendoni pohimet e mëposhtme:

(1-Nuk është problem, 3-Problem i rëndësishëm)

Problematikat	1	2	3
Ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë			
Ndotja e tokës			
Djegia e mbetjeve			
Mbetje të hedhura përgjatë bregut të lumit			
Parazitë, minjtë, insekte			

Pluhuri			
Kundërmimi (Era e keqe)			
Zhurma			
Sëmundjet e shkaktuara nga mikroorganizmat etj. që lidhen me vend depozitimet ekzistuese			
Tjetër _____			

B2. A keni dëgjuar më parë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta?

☐ PO ⁽¹⁾

☐ JO ⁽²⁾

B2a Nëse Po, Ku e morët informacionin? (më shume se një përgjigje)

☐ Radio ⁽¹⁾

☐ TV ⁽²⁾

☐ Gazetë ⁽³⁾

☐ Revistë ⁽⁴⁾

☐ Internet ⁽⁵⁾

☐ Nga miqtë/ të afërmit ⁽⁶⁾

☐ Tjetër, specifikoni _____ ⁽⁷⁾

B3. Çfarë tipe / lloje mbetjesh gjeneron familja juaj? (më shume se një përgjigje)

☐ Letër dhe karton ⁽¹⁾

☐ Plastike (qese/ shishe) ⁽²⁾

☐ Ushqime ⁽³⁾

☐ Qelq ⁽⁴⁾

☐ Të tjera ⁽⁵⁾

B4. Në çfarë ku i grumbulloni mbetjet ne familjen tuaj? *(më shume se një përgjigje)*

- ☐ Kosha te ndare ⁽¹⁾
- ☐ Kosh mbeturinash ⁽²⁾
- ☐ Qese plastike ⁽³⁾
- ☐ Tjetër _____ ⁽⁴⁾

B5. Zakonisht, ku i hidhni mbeturinat që grumbulloni?

- ☐ Në koshat publik ⁽¹⁾
- ☐ Anës lumit ⁽²⁾
- ☐ Në rrugë apo përgjatë rrugës ⁽³⁾
- ☐ Në një hapësirë të hapur ⁽⁴⁾
- ☐ Tjetër _____ ⁽⁵⁾

B6. A ndodhen kosha publik afër vendbanimit tuaj?

- ☐ PO ⁽¹⁾
- ☐ JO ⁽²⁾

Nëse PO, ju lutem përgjigjuni setit të mëposhtëm të pyetjeve:

B6a. Sa minuta larg vendbanimit tuaj ndodhen koshat publik?

- ☐ 5-10 min ⁽¹⁾
- ☐ 11-15 min ⁽²⁾
- ☐ 16-20 min ⁽³⁾
- ☐ Tjetër _____ ⁽⁴⁾

B6b. Sa shpesh zbrazen koshat e mbeturinave nga ndërmarrja e pastrimit?

- ☐ 1 herë në javë ⁽¹⁾

- ☐ 2 herë në javë ⁽²⁾
- ☐ 3 herë në javë ⁽³⁾
- ☐ Çdo ditë ⁽⁴⁾
- ☐ Nuk e di ⁽⁵⁾
- ☐ Tjetër _____ ⁽⁶⁾

B7. A mendoni se mënyra e grumbullimit të mbetjeve në zonën tuaj është e duhura?

- ☐ PO ⁽¹⁾
- ☐ JO ⁽²⁾

B9. Si do ta vlerësoje shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonën tuaj?

- ☐ Shumë i dobët ⁽¹⁾
- ☐ I dobët ⁽²⁾
- ☐ Mesatar ⁽³⁾
- ☐ I mirë ⁽⁴⁾
- ☐ Shumë i mirë ⁽⁵⁾

III. MENAXHIMI I MBETJEVE NGA BASHKIA

C1. A keni dijeni për tarifën e pastrimit që aplikon bashkia juaj?

- ☐ PO ⁽¹⁾
- ☐ JO ⁽²⁾

C2. A keni dijeni për shërbimet që mbulohen përmes tarifës së pastrimit?

- ☐ Po, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve ⁽¹⁾

☐ Po, grumbullimi, transporti dhe trajtim përfundimtar i mbetjeve ⁽²⁾

☐ Nuk e di ⁽³⁾

C3. A keni qenë pjesë e dëgjësive publike të organizuara nga bashkia për përcaktimin e tarifës së pastrimit?

☐ PO ⁽¹⁾

☐ JO ⁽²⁾

C4. Sa është tarifa e pastrimit për familje, që ju paguani në vit në zonën tuaj?

SHËNIM: Tarifa maksimale e aplikuar në bashkinë Kamëz është 6000 lekë/vit

_____ALL/Vit

C5. Si paguhet kjo tarifë?

☐ Është pjesë e faturës së ujit ⁽¹⁾

☐ Fatura lëshohet në zyrën e bashkisë vetëm kur kërkoni shërbime administrative ⁽²⁾

☐ Nuk kam marrë asnjëherë faturë ⁽³⁾

☐ Nuk e di ⁽⁴⁾

☐ Tjetër, specifikoni _____ ⁽⁵⁾

C6. A e paguani tarifën e pastrimit?

☐ Po, e paguaj çdo muaj, me faturën e ujit ⁽¹⁾

☐ Po, e paguaj rregullisht, një herë në vit, vullnetarisht ⁽²⁾

☐ Po, e paguaj vetëm kur kam nevojë për shërbime administrative nga bashkia ⁽³⁾

☐ E paguaj ndonjëherë vullnetarisht ⁽⁴⁾

☐ Nuk e paguaj ⁽⁵⁾

Nëse përgjigja Nuk paguaj (6), ju lutem përgjigjuni pyetjes së mëposhtme:

C6a. Cilat janë arsyet që nuk e paguani tarifën e pastrimit?

- ☐ Nuk e di që ka tarifë pastrimi për të paguar⁽¹⁾
- ☐ Askush nuk më kërkon ta paguaj, dhe nuk penalizohem nëse nuk e paguaj⁽²⁾
- ☐ Nuk e përballoj dot⁽³⁾
- ☐ Nuk më ofrohet shërbim⁽⁴⁾
- ☐ Ofrim i dobët shërbimi⁽⁵⁾
- ☐ Tjetër _____⁽⁶⁾

C7. Si paraqitet situata aktuale e menaxhimit të mbetjeve në zonën tuaj:

- ☐ Shqetësuese, ka vend grumbullime mbeturinash kudo në rrugë dhe afër vendbanimeve⁽¹⁾
- ☐ Ka vend grumbullime mbeturinash, por ndodhen larg vendbanimit tim⁽²⁾
- ☐ Nuk kam dëshirë të pronocohem për situatën⁽³⁾

Nëse përgjigja (1) dhe (2), ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

C7a. A jeni drejtuar prane njesise administrative perkatese per te mare nje zgjidhje per problematiken keqmenaxhimin e mbetjeve?

- ☐ PO
- ☐ JO

C7b. Nëse PO, a janë marrë masa për zgjidhjen e problemit:

- ☐ PO
- ☐ JO

C7c. Nëse JO, a i keni ndjekur të gjitha hapat e shqyrtimit të një ankese duke filluar nga:

Marrja e një përgjigje nga Bashkia Kamëz (Zgjat zakonisht 10-15 ditë) për shqyrtimin e ankesës

☐ PO ☐ JO

Dërgimin e ankesës pranë komisionit të ankimimit ☐ PO ☐ JO

Shqyrtimi i ankesës dhe krijimi i një task force për investigimin e problemit ☐ PO ☐ JO

Nëse të gjitha pohimet janë JO, a keni marr një përgjigje nga Bashkia, pse nuk është zgjidhur problemi:

C8. Kush mendoni se është përgjegjës për situatën e vendgrumbullimeve përgjatë lumit Ishëm dhe zonës përreth:

☐ Banorët⁽¹⁾

☐ Ndërmarrja e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve⁽²⁾

☐ Neglizhenca e Bashkisë Kamëz⁽³⁾

☐ Tjetër, specifikoni _____⁽⁴⁾

IV. MENAXHIMI I MBETJEVE -EFEKTET SHËNDETËSORE

D1. Cili është burimi i ujit të pijshëm?

☐ Ujësjiellës kanalizime⁽¹⁾

☐ Puse⁽²⁾

☐ Ujë i blerë me bote⁽³⁾

☐ Tjetër, specifikoni _____⁽⁴⁾

D2. Cili është niveli juaj i kënaqësisë për furnizimin me ujë (duke konsideruar të gjitha aspektet e tij)?

☐ I pakënaqur (nëse jeni shumë i pakënaqur, shkoni te D3a) ⁽¹⁾

☐ I kënaqur ⁽²⁾

☐ Shumë i kënaqur ⁽³⁾

D2a. Nëse nuk jeni të kënaqur me furnizimin aktual me ujë cila është arsyeja kryesore?

☐ Uji që vjen është i dëmshëm për shendetin⁽¹⁾

☐ Kosto shumë të larta⁽²⁾

☐ Shije dhe aroma e pa këndshme për tu konsumuar⁽³⁾

☐ Orar i kufizuar furnizimi ⁽⁴⁾

☐ Tjetër, specifikoni _____⁽⁵⁾

D3. Ju apo ndonjë antarë familjes suaj, vuani nga ndonjë sëmundje kronike?

☐ PO⁽¹⁾

☐ JO⁽²⁾

D3a. Nëse PO, nga cilat nga problemet e listuara më poshtë jeni prekur:

☐ Probleme me rrugët respiratore (Alergji, astma, Koll kronike, Vështirësi në frymëmarrje) ⁽¹⁾

☐ Probleme me sytë (Sy të kuq, sy të lotueshëm, kruajtje sysh) ⁽²⁾

☐ Probleme me stomakun (Diarre, tëvjella, dhimbje stomaku/ barku) ⁽³⁾

☐ Dhimbje koke ⁽⁴⁾

☐ Tjetër, specifikoni _____⁽⁵⁾

Komente të tjera

ANEKS 3. INTERVISTA ME PËRFAQËSUESIT E BIZNESEVE

Unë quhem _____, vullnetar/e pranë Enforce Albania. Kjo intervistë është pjesë e projektit “Metamorfoza e lumit Ishëm-Itinerari i së nesërme”, i cili zbatohet në Bashkinë Kamëz dhe mbështetet financiarisht nga Lëviz Albania. Kjo intervistë do të zgjasë jo më shumë se 10 minuta. I gjithë informacioni që ju do të ndani me ne, do të jetë i rëndësishëm për të kuptuar nevojat dhe problematikat e bizneseve lidhur me aspekte mjedisore, shëndetësore dhe ligjore të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në zonën e studimit. Të dhënat e marra nga kjo intervistë do të trajtohen si informacion konfidencial dhe do të jenë të disponueshme vetëm për kryerjen e studimit.

Pjesëmarrja juaj në këtë vlerësim është tërësisht vullnetare. Ju lutemi, përgjigjuni secilës pyetje me vërtetësi, në mënyrë që të dhënat të paraqesin situatën reale.

☐Pranon të intervistohet ☐Nuk pranon të intervistohet

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. Emri i biznesit

2. Madhësia e biznesit

- a) E madhe
- b) I mesëm
- c) I vogël

3. Kategoria e biznesit?

- a) Shitje me pakicë/shumicë
- b) Shërbime
- c) Bar/Restorant
- d) Tjetër (Specifiko) _____

4. Vitet e operimit në treg?

- a) 2 vite
- b) 3-5 vite
- c) më shumë se 5 vite

II. MENAXHIMI I MBETJEVE NË KOMUNITET

5. Cilat janë problematikat tuaja kryesore në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në zonën ku ndodhet biznesi juaj? (Disa nga problematikat me shqetësuese)

1. _____
2. _____

3. _____
4. _____
5. _____

6. A keni marr ndonjë informacion nga bashkia për deponimin e mbetjeve?

☒ PO ☐ JO

7. Sa shpesh zbrazen koshat e mbeturinave nga ndërmarrja e pastrimit?

- ☐ 1 herë në javë
- ☐ 2 herë në javë
- ☐ 3 herë në javë
- ☐ Çdo ditë
- ☐ Nuk e di
- ☐ Tjetër _____

**8. A i ndani mbeturinat në biznesin tuaj sipas kategorive?
(Plastik/ Letër-Karton/ Qelq/ Të tjera)**

- ☐ PO
- ☐ JO

9. Çfarë llojesh mbetjesh gjeneron biznesi juaj?(më shume se një përgjigje)

- ☐ Letër dhe karton
- ☐ Plastike (qese/ shishe)
- ☐ Ushqime
- ☐ Qelq
- ☐ Të tjera

10. A mendoni se mënyra e grumbullimit të mbetjeve të zonën tuaj është e duhura?

- ☐ PO

☐ JO

Nëse JO, Çfarë masash duhet të ndermarre bashkia/ ndërmarrja e grumbullimit për të përmirësuar shërbimin?

11. A mendoni se tarifa që paguani për pastrimin justifikon shërbimin që merrni?

1. PO
2. JO

Cfare tarife pastrimi paguani mesatarisht ne vit? _____ ALL/Vit

12. A eshte prekur biznesi juaj nga mosmenaxhimi i duhur i mbetjeve ?

Si ka ndikuar kjo situatë në gjendjen ekonomike të biznesit? P.sh, në lidhje me klientet, nivelin e shitjeve

A i jeni drejtuar Njesisë Administrative/ Bashkisë për zgjidhjen e problemit? **Nëse PO,** a janë marr masa për zgjidhjen e problemit ?

13. Cfare masash rekomandoni te merren nga biznesi per menaxhimin e mbetjeve??

Po nga bashkia, cfare do te sugjeronit per te permiresuar situaten?

Ju lutem listoni 3 masa te menjëhershme
